



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:223918

Datë: 07.06.2022

Numri i dokumentit: 03104177

K.nr.1004/21

Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Kundërvajtje, sipas gjyqtarit Menderes Behluli dhe zyrtares ligjore Erzë Mustafa, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit T. A nga Gjilani, për shkak të veprës kundërvajtëse të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **36 paragrafi 7**, të Ligjit mbi Pyjet nr.2003/3, Ligjit nr.2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr.03/L-153/2010 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, e konform nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119 dhe 124, të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datën **07.06.2022** shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit T. A, nga babai I..., i lindur më ..., me numer personal ..., nga Gjilani rr.”...”p.nr, i pa punë, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me datën **11.09.2021** aty rreth orës **21:00** min. të lartepmendurim policia kufitare e Kosoves e ka takuar në rrugë të fshatit Pogradje, duke transportuar dru bungu të pa vulosura dhe pa fletëpercjellse, në sasi prej 2.30 m3, drutë e prera i ka transportuar me kombi “**PEUGEOT**” me targa ..., i njejt i ka shkaktuar dëm Agjencionit Pyjor në vlerë prej 294.40 euro.

-me ç’veprim ka kryer veprën kundërvajtëse, të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 7, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3, për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, andaj

D E N O H E T

Me dënim me gjobë në larësi prej **100 (njëqind) €**, të cilën gjobë, i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t’i paguajë kësaj gjykate shumën prej **5 €** , në afat të njëjtë sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi 1 pika 6, të LMK-së.

Nga një kopje e aktgjykimi t'iu dorëzohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

A.P.K–ja, në Gjilan, me datën **22.09.2021** ka paraqitur kërkesën me nr..... për inicimin e procedurës kundervajtëse, kundër të pandehurit të lartëshenuar dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe ndëshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ftoi të pandehurin me ftesë që të paraqitet në gjykatë, i cili në deklaratën e tij theksoi se është e vërtetë se me datën 11.09.2021 vërtetë se është ndaluar nga policia e Kosovës me kombi ku ishte duke transportuar disa drutë thata të përziara e që i kishte marrë për shfrytëzim për nevoja familjare për vete dhe vërtetë ishin pa fletpërcjellje dhe të pa vulosura, andaj i vije keq kërkon ndjesë, kërkon falje për këtë herë dhe lut gjykatën që ti mer parasysh keto rrethana si lehtësuese dhe me rastin e vendosjes ti shqiptoj një dënim sa më të vogël minimal.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtari mori në pyetje personin zyrtar pylltarin O. I në cilësinë e dëshmitarit i cili deklaroi se vërtetë me datë **11.09.2021** në orën **21:00** min në terrenin e fsh.Pogragjë, në rrugë, është takur nga Policia Kufitare e Kosovës, duke transportuar dru të bungu me automjet “**PEUGEOT**” me tabela ..., me dm 12-14 cm, me lartësi 1 m, prej 2.30 m3, të pa vulosura dhe të pa damkosura.

Gjyqtari pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe deklaratave të të pandehurit, dhe personit zyrtar dëshmitarit erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë prova të mjaftueshme, se i pandehuri është kryerës i veprës kundervajtës prerje dhe transportimi ilegal i druve, vepër kjo e paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **36 paragrafi 7**, të Ligjit mbi Pyjet nr.2003/3, Ligjit nr.2004/29 dhe nenit 14 të Ligjit nr.03/L-153/2010 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, për të cilën të njëjtin e shpalli përgjegjës dhe e ndëshkoi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjyqtari me rastin e shqiptimit të dënimit mori për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 31 të LMK-së, pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundervajtëse, rrethanat në të cilën është kryer vepra kundervajtëse dhe të njëjti i shqiptoi këtë dënimin të paraparë ligjor, me bindje se edhe me një dënim të këfillë do të arrihet efekti i dënimit tek i pandehurit që në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla kundervajtëse .

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni për Kundervajtje,
Me datën 07.06.2022**

**Zyrtarja ligjore,
Erzë Mustafa**

**Gjyqtari,
Menderes Behluli**

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, paraqitësi i kërkesës dhe pala e pandehur mund të paraqesin ankesë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit-Divizioni për Kundervajtje në Prishtinë, ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.